



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:068525

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05810700

KPPP.nr. 120/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Gjakova” Sh.A, me numër të biznesit 70433554 dhe me seli në Gjakovë, rr. “UÇK”, nr. 7, kundër debitorit B.J. -“Arena”, me seli në Gjakovë, rr. “Pashko Vasa”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 155/22 të datës 23.03.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi me seli të zyrës në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 11.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit B.J.-“Arena”, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 155/22 i datës 23.03.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Gjakova” Sh.A, me datë 23.03.2022 ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 155/22 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Ekstrakt nga librat e kontabilitetit me shifrën 030824 për periudhën kohore nga data 01.07.2008 e deri më datë 15.03.2022, ashtu që është detyruar debitori që në emër të borxhit të papaguar për shërbimet e furnizimit me ujë, t’ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 864.30 EUR (tetëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e tridhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8 % nga data e propozimit për përmbartim e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të këtij propozimi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbarimit me arsyetim se për borxhin si në propozimin për përmbarim herë pas here ka bërë pagesa, e së fundi me datë 15.03.2022 ka paguar shumën prej 100.00 €. Ka shtuar se për pjesën tjetër të borxhit e ka pasur të pamundur që të paguajë për shkak të pandemisë, duke mos patur mundësi që të realizojë të ardhura. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të pezullohet deri në një marrëveshje me kreditorin.

Kreditori në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e ngritura nga debitori, duke sqaruar se i njëjti nuk mbështetet në prova, siç përcaktohet me nenin 69, par. 4 të LPP-së. Ka shtuar se debitori me datë 21.06.2021 ka nënshkruar marrëveshje për riprogramim me kreditorin për pagesën e borxheve të vjetra dhe atyre vijuese, marrëveshje kjo e paraparë për fshirjen e borxhit prej 1,549.09 € për 24 muaj, në shumën e kështit 64.55 €, ku i njëjti ka paguar shumën prej 50 €. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, si dokumente të besueshme listohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”* ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata në rastin konkret gjeti urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – Ekstrakt nga librat e kontabilitetit me shifrën 030824, e cila i ka atributet e një ekstrakti nga librat afarist i cili parashihet si dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29, par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, dhe përmban të gjitha elementet e kërkuara me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, meqenëse në këtë dokument janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Tutje, Gjykata gjeti se dokumenti mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri përmbartimor i plotëson kushtet edhe në kuptim të nenit 37 të LPP-së, pasi që i njëjti i është bashkangjitur propozimit për përmbartim në origjinal, andaj edhe është i përshtatshëm për përmbartim dhe paraqet bazë për lejimin e përmbartimit.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim por gjeti se i njëjti nuk ka paraqitur asnjë provë siç përcaktohet me nenin 69.4 të LPP-së për vërtetimin e një prej shkaqeve taksative të parapara me nenin 71 të LPP-së si bazë për anulimin e urdhrin për lejimin e përmbartimit, andaj u vendos që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbartimit të mbetet në fuqi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73, par.3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 120/24, datë 11.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.